



P R O C E S V E R B A L I

Mbledhja e Komitetit për Komunitete e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më datë: **11.07.2025**, me fillim në orën **10:05**. Këtë mbledhje e kryesoi si zakonisht kryesuesi i Komitetit për Komunitete, **z. Bajram Morina**.

Kryesuesi: Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! Faleminderit për kontributin dhe praninë tuaj. Përshëndetje për zëvendëskryesuesin, Dusan Stojanovic, shefin e zyrës për komunitete z. Lendrit Qelin, drejtorin e Bujqësisë, z. Berat Duraku dhe togerin Sedat Shehu. Përshëndetje po ashtu edhe për përfaqësuesit e KFOR-it, OSBE-së, anëtarët e Komitetit për Komunitete dhe të gjithë të pranishmit. Ky është takimi i **katërt** për vitin 2025, për takimin e sotëm i kemi këto pika të rendit të ditës:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Informatë nga drejtoria për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural rreth subvencioneve të komuniteteve joshumicë;
3. Informatë nga stacioni policor në Rahovec, rreth gjendjes së sigurisë te komuniteti joshumicë në Komunën e Rahovecit;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi: Atëherë, ky është rendi i ditës për sot. Nëse dikush nuk ka diçka për të thënë, si të tillë po e vendosim! Kush është “për”?... Me shumicë unanime aprovohet rendi i ditës.

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: A ka dikush ndonjë gjë rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Konstatoj që unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës.

2. Informatë nga drejtoria për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural rreth subvencioneve të komuniteteve joshumicë:

Berat Duraku: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për anëtarët e Komitetit për Komunitete! Para vetes e keni një informatë që ka të bëjë me subvencionet nga komuna për komunitetet joshumicë. Në kuadër të thirrjeve publike në sektorin e bujqësisë, fermerët nga komuniteti jo shumicë kanë aplikuar në mënyrë të barabartë dhe pa asnjë dallim nga qytetarët e tjerë. Ata kanë pasur qasje të plotë në informacion, dokumentacion dhe asistencë teknike gjatë procesit të aplikimit. Si rezultat i kësaj, disa prej tyre janë përzgjedhur si përfitues të granteve dhe subvencioneve, duke përfituar nga komuna në funksion të zhvillimit të kapaciteteve të tyre prodhuese. Kjo dëshmon që, Komuna e Rahovecit përfshin në trajtim të plotë dhe të barabartë të gjithë qytetarët, pa dallim etnie. Në informatë i keni të shkruara detajisht të gjitha.

Ramë Berisha: Përshëndetje për të gjithë! Ju falënderoj për të gjitha ndihmat dhe lehtësirat për fermerë, fokus në sektorin e bujqësisë. Ndarja e mjeteve për mbijetesë të bujqësisë dhe të fermerëve si: serra dhe mekanizma bujqësorë ndikojnë pozitivisht në rritjen e kapaciteteve bujqësore. Personalisht kam aplikuar, sepse e kam një “bahçe” sa për ta kaluar kohën. I kam dorëzuar aplikacionet për subvencione. Ka ardhur komisioni vlerësues dhe e ka shikuar vendin, si dhe e kanë fotografuar. Në fund, nuk e kam fituar

subvencionin, me arsye që kinse nuk e punoj – nuk e shfrytëzoj. Përkundrazi, që ka viti 2015 e punoj serrën rregullisht me perime. Asnjëherë nuk jam përkrahës i idesë që asaj që “nuk është” t’i them që “është”.

Berat Duraku: Baca Ramë, ti e din shumë mirë që vendimmarrjen për këto subvencione e kanë pasur, sipas marrëveshjes “Qatar Charity”, e kemi biseduar edhe në zyrë. Përndryshe, 2 fermerë janë përfitues nga komuniteti joshumicë.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor, faleminderit baca Ramë! Atëherë, nëse dikush nuk ka edhe diçka, vazhdojmë me pikën e tretë.

3. Informatë nga stacioni policor në Rahovec, rreth gjendjes së sigurisë te komuniteti joshumicë në Komunën e Rahovecit:

Sedat Shehu: Faleminderit! Përshëndetje për të gjithë! Unë jam Sedat Shehu – Shef i Sektorit të Hetimeve. Po ju informoj në vija të trasha rreth gjendjes së sigurisë sipas pikës së rendit të ditës. Sa i përket gjendjes së sigurisë te komuniteti joshumicë, gjendja gjatë kësaj periudhe ka qenë e qetë dhe mjaft stabile. Kanë ndodhur 16 raste të veprave penale dhe prej tyre 5 raste te komuniteti serb, 4 raste te komuniteti ashkali, 4 te komuniteti rom dhe 3 raste te komuniteti egjiptian. Të gjitha rastet janë ceduar në prokurori dhe vazhdojnë sipas procedurave ligjore.

Lendrit Qeli: Faleminderit shumë për këtë informatë! Është mirë ta kemi një informatë të tillë më shpesh dhe ta forcojmë raportin konstruktiv, në mes të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe policisë së Kosovës.


Sedat Shehu: Lendrit, ju zyrën e keni shumë afër me stacioni e policisë, për këto lloj informatash je i mirëseardhur çdo herë, pa termin.

4. Të ndryshme:

Kryesuesi: Ju falënderoj shumë! Nëse edhe dikush nuk ka diçka për të shtuar te pika e fundit, konsideroj që e kemi përfunduar takimin e katërt me radhë. Shihemi në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi: 10:30

Procesmbajtësi


Albion Krasniqi

Kryesuesi i mbledhjes


Bajram Morina

